

përdorimi i titujve si kolateral për kreditë?

Mund të përmendim disa avantazhe kryesore:

- Plotësimi i nevojave të menjëher-shme për likuiditete brenda një kohe shumë të shkurtër, pa sakrifikuar interesat e investimit të kryer.
- Zgjedhja midis metodave të ndryshme të ripagimit të principalit. Nëse zgjidhet mënyra e ripagimit me këste të barabarta mujore, ose me shuma principali të njëjtë çdo muaj, për klientin krijohet një mundësi e shkëlqyer për të investuar në një pasuri të re, duke mos prekur kursimet që tashmë janë investuar dhe gjenerojnë të ardhura shtesë.
- Afati i procesimit të kërkesës për kredi është shumë i shkurtër, kjo falë

listës së reduktuar të dokumenteve që kërkohen, si dhe të procedurave të shpejta që ndiqen për bllokimin e kolateralit.

- Kostot për lëvrimin e kredisë janë shumë më të ulëta në krahasim me llojet e tjera të kredive (këtu përfshihen komisioni i disbursimit, norma e interesit, kostot noteriale, tarifat për bllokimin e titullit të ofruar si kolateral, etj.).
- Kreditë e siguruar me tituj me vlerë nuk kanë kufizime në qëllimin për të cilin do të përdoren. Madje deri në një nivel të caktuar të kredisë, nuk kërkohet të paraqitet ndonjë dokument justifikues për qëllimin e kredisë, por pranohet vetëm deklarimi sesi do të përdoren fondet e kredisë.

A shihni potenciale për përdorimin më të madh të titujve si kolateral për kreditë dhe si mund të realizohet kjo?

Duke marrë parasysh vlerën e ulët të portofolit të kredive të siguruar me këtë tip kolaterali, mendojmë se ka potencial për përdorim më të madh. Në këtë drejtim mund të punohet më shumë për edukimin dhe informimin e klientëve mbi avantazhet dhe disavantazhet e investimit të fondeve në Tituj Qeveritarë, si dhe mbi përfitimet shtesë që mund të vijnë nga marrja e një kredie të siguruar me këtë tip kolaterali. Për më tepër, edhe nga ana e sistemit bankar ka vend për përmirësim në drejtimin e promovimit më të gjerë të këtij lloji produkti. ■

PËRDORIMI MË I MADH I KOLATERALEVE NË TITUJ NDIHMON RRRITJEN E KREDITIMIT

Përfshirja e titujve qeveritarë si kolateral për huadhënien mund të sjellë në mënyrë direkte edhe rritjen e kreditimit të ekonomisë. Soni Thano, Drejtore e Divizionit të Riskut në Credins Bank, thotë për “Monitor” se përdorimi i titujve si kolateral zbut rrezikun për bankën dhe mundëson kushte më të favorshme financimi për kredimarrësin.

Sa përdoren aktualisht titujt e qeverisë si kolateral për kreditë bankare?

Për gjithë sistemin bankar, sipas të dhënave të Bankës Qendrore, vlerësohet se pesha e cash-it dhe kolateraleve të tjera të përdorura si kolaterale për kreditimin arrin përkatësisht në nivelet e rreth 20 miliardë lekëve dhe rreth 160 miliardë lekëve. Sidoqoftë, në këto grupime llojesh kolateralesh, pesha me tituj të emetuar nga qeveria shqiptare vlerësohet shumë më e ulët. Një faktor pozitiv është se nivelin më të ulët të raportit të kredisë me probleme vijon ta mbajë kredia e kolateralizuar me para në dorë, ndërkohë që pesha e stokut të kredive me probleme për këtë lloj kredie në totalin e kredive me probleme është shumë e ulët, afër zeros, kurse raporti i kredisë me probleme për klasën e kredisë së kolateralizuar me “kolateral jetër” arrin në 5.9%.



Në cilat segmente të klientëve dhe kategori të klientëve janë përdorur deri tani titujt qeveritarë si kolateral?
Sipas të dhënave të AMF-së për tregun me pakicë të titujve për 2023, vlerësohet se portofoli i titujve të lënë si kolaterale nga individët/persona juridikë arrin në

rreth 1.59 miliardë lekë, ku peshën më të lartë e kanë personat juridikë me 74% dhe individët me 26%. Ndërkohë për individët kjo vlerë është sa 1.1% e blerjeve të titujve të kryera gjatë vitit 2023 në tregun primar, ndërsa për totalin e këtyre titujve si kolaterale arrin në 3.97% të blerjeve në ankandet primare në tregun me pakicë për 2023.
Në varësi të kohëzgjatjes së financimeve të marra nga klientët, në total, vlera e titujve të vendosur si garanci ka rezultuar në rreth 3.58 miliardë lekë vetëm për periudhën e konsideruar gjatë viteve 2020-2023. Në dy vitet e fundit, vendosja e titujve si kolateral ka njohur rritje të ndjeshme dhe këto instrumente janë përdorur gjerësisht edhe nga personat ligjorë. Peshja e individëve vërehet në kushte relativisht të njëjta edhe pse ka një trend pozitiv në shfrytëzimin e këtyre mundësive prej individëve. Për Bankën Credins, klientela që ka shfrytëzuar titujt qeveritarë si mundësi mbështetjeje për kolateral ka ardhur si nga segmenti i individëve, ashtu edhe nga ai i bizneseve. Për bankën vërehet përdorimi më i gjerë i titujve më afatgjatë të obligacioneve qeveritare të lëna garanci për ekspozimet në kredi të marra nga klientët. Megjithatë, ka pasur përdorim edhe të bonove të thesarit, veçanërisht për disbursime më afatshkurtra. Për sa u përket segmenteve, vlen të theksohet se volumet më të larta



të kredidhënies që mbulohen me këtë lloj kolaterali lidhen kryesisht me institucionet financiare të mikrokredisë, të cilat rezultojnë më të përgatitura jo vetëm në njohuritë, por edhe në nivel shifrash investimi referuar këtyre instrumenteve. Nëpërmjet kësaj mënyre, këta të fundit diversifikojnë mënyrat e investimit dhe krijojnë kolateral për të mbuluar nevojat e kërkesave për fonde, për të vazhduar operativitetin e tyre.

Çfarë specifikash parashikon sigurimi i kredive duke përdorur si kolateral letrat me vlerë dhe cilat janë ndryshimet krahasuar me llojet e tjera të kolateralit?

Lehtësi në dokumentacionin e kërkuar nga bankat dhe në afatet e shqyrtimit dhe miratimit të kredisë. Kredia procesohet brenda ditës në raste kur Credins Bank është kujdestare. Normat e interesit të aplikuara mbi kreditë janë më të ulëta se ekspozimet e mbuluara me forma të tjera garancish. Kjo lidhet me nevojën më të ulët për kapital, duke sjellë rrjedhimisht rrezik më të ulët për bankën dhe kosto më të ulët për klientët. Kredia e mbuluar me kolateral “Letra me Vlerë”, nuk aplikon penalitet në rastin e mbylljes para kohe. Në rastin kur klienti nuk ka mundësi që ta shlyejë këstin, mund të bëjë shitje të pjesshme ose totale të letrës me vlerë për të paguar këstin e radhës, ose të mbyllë në total kredinë. E gjitha kjo për faktin se kolaterale në formën e titujve të borxhit qeveritar kanë një nivel tregtueshmërie dhe likuiditeti të lartë në krahasim me kolaterale të përdorura gjerësisht në formën e pasurive të paluajtshme dhe atyre të luajtshme, përveç rastit të mbulimit me kolateral cash brenda bankës nga ana e klientëve. Klienti mund zgjedhë një nga mënyrat e pagesës: pagesë mujore me këste të rregullta, pagesë me këste të rregullta ose një pagesë të vetme në fund të maturimit (nëse maturiteti i kredisë nuk kalon 12 muaj). Për kreditë me kolateral, letra me vlerë nuk aplikohet sigurimi i jetës dhe sigurimi i pronës, ndryshe

nga kreditë e tjera për individët të cilëve u shtohen këto kosto për garantimin e mbulimit me garanci. Për kreditë me kolateral letra me vlerë, moshja e lejuar ka një tolerancë më të lartë në krahasim me llojet e kredive të tjera për individët, deri në afatin e maturimit të kredisë, duke zgjeruar edhe bazën e individëve/familjeve që mund të shfrytëzojnë huamarrjen nga bankat.

Ekzistojnë aktualisht vështirësi apo problematika të lidhura me garantimin e kredive, nëpërmjet kolateralit në formën e bonove ose obligacioneve?

Në përgjithësi, huamarrja me mbulim, me garanci me tituj, paraqet kushte më të shpejta të procesimit, në krahasim me rastet e garantimit me kolaterale pengje ose forma të tjera të paluajtshme dhe është e preferuar nga bankat. Pikat që eksperiencia na ka paraqitur si nevojë për përmirësim janë:

- Mundësia e regjistrimit të bllokimit të titullit në favor të bankës në listat e regjistrit të titujve pranë Bankës së Shqipërisë;
- Mundësia e bllokimit dhe regjistrimit të kalimit të pronësisë së titujve në favor të bankave, në rastet kur banka të tjera janë kujdestare të titujve, në krahasim me bankat nga ku është marrë huaja.

Cilat mund të jenë avantazhet kryesore për huamarrësit nga përdorimi i titujve si kolateral për kreditë?

-Ruajtja dhe shfrytëzimi i pasurive të klientëve, duke gjeneruar njëkohësisht fonde dhe likuiditete shtesë për nevoja dhe qëllime të tjera;

- Lehtësi në procesin dhe në kushtet kredituese në rastet e mbulimit të huasë me kolateral tituj;
- Kosto më të ulëta të shërbimit të kredisë;
- Lehtësi në dokumentacionin e nevojshëm për shfrytëzimin dhe bllokimin

- e titujve të lënë garanci për kreditë;
- Ruajtja e përfitimeve nga rendimenti i prodhuar nga tituj;
- Në varësi të kohëzgjatjes së huave dhe të kushteve të ripagimit të tyre, krijohet edhe mundësia e realizimit të marzheve pozitive të rendimentit nga këto investime në kohë, veçanërisht në rastet e obligacioneve më afatgjata që prodhojnë flukse fikse të ardhurash nga interesat, ndërkohë që amortizimi më i shpejtë i kredive me këste sjell edhe uljen e shpenzimeve për interesa në kohë.

A shihni potenciale për përdorimin më të madh të titujve si kolateral për kreditë dhe si mund të realizohet kjo?

Hapësira që ka tregu ku është investuar në tituj, në krahasim me kërkesën për kreditim, është ende në nivele të ulëta dhe ka mundësi të mëdha për shfrytëzim. Duke parë pozicionin neto financiar të individëve, gjatë vitit 2023, kontribut pozitiv në zgjerimin e këtij pozicioni financiar dhanë depozitat në Lek dhe investimet në titujt e qeverisë kryesisht në bono thesari, ndërsa investimet në fondin e investimeve dhe pensioneve ruajtën nivelet e mëparshme. Në dy vitet e fundit, 2022-2023, ka pasur një numër të lartë të individëve që janë përfshirë në transaksione në blerje të titujve të qeverisë, duke arritur në shifrat e 13-17 mijë individëve, që përbën një rritje të konsiderueshme në krahasim me vitet e mëparshme. Nga kjo popullatë investuesish, në përgjithësi bankat po shërbejnë me transaksione në tituj një pjesë goxha të vogël të tyre. E njëjta gjendje është edhe për financimin e këtyre investitorëve nëpërmjet shfrytëzimit të këtyre instrumenteve financiare, si garanci për mbulimin e huave. Sipas të dhënave të Ministrisë së Financave, për shtatorin e vitit 2023, borxhi i mbajtur nga individët me investime direkte arrin në rreth 93 miliardë lekë, ndërkohë bashkë me borxhin e mbajtur nga bankat në emër të klientëve të tyre, prej rreth 59 miliardësh, në total hapësira për shërbim të individëve/klientëve që janë investitorë në tituj qeveritarë shkon në mbi 152 miliardë lekë. Zgjerimi i këtyre mundësive do të sjellë përmirësim të infrastrukturës financiare, si në drejtim të diversifikimit të mënyrave të financimit për individët apo shoqëritë, ashtu edhe në drejtim të shtimit të mirëqenies financiare të vetë investitorëve, qofshin këta individë apo biznese. Kjo sepse këto forma investimi ofrojnë norma interesi të mira dhe kanë një ekspozim në risk të konsideruar tepër të ulët. ■